



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Uprava za Zdravstvo i Socialnu Zastitu/Department of Health and Social Welfare

Data/Datum/Date:	22.12.2022
Nr./Br./No	07/346
Për/Za/To:	Komitetin e Shëndetësisë
Përmes/Preko/Through:	Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS-ës
Nga/Od/From:	Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Lumnie Aliu – Zyrtar Adm.
Lënda/Predmet/Subject :	Raport

Raport i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ky raport përfshinë aktivitetet e DSHMS-ës dhe organizatave buxhetore që i subordinojnë kësaj drejtorie, për periudhën Janar-dhjetor të vitit 2022 .

A. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë , si sektor me rëndësi të veçantë, që zhvillon veprimtarinë e vetë në kuadër të Komunës së Shtimës, ka realizuar në një masë të madhe dhe në afate kohore, planet e parapara sipas kalendarit të realizimit të tyre.

Gjatë periudhës Janar- dhjetor, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë tona, janë kryer këto aktivite:

A. Punët në administratën e Drejtorisë janë realizuar sipas planit të punës:

Janë pranuar gjithsejtë 427 kërkesa, prej të cilave :

1. 284 kërkesa janë për nënat lehona me për fëmijë të lindur gjatë vitit 2022, prej tyre janë përfituese :

- 250 kërkesa në vlerë prej **25,600** euro,
 - 22 kërkesa janë në procedurë për ekzekutim dhe
 - 12 prej tyre janë në procedurë të kompletimit.
2. **9** kërkesa janë të OJQ-ve, prej të cilave
- 8 janë përfituese në vlerë prej gjithsejtë: **13,800 €**
 - 1 është refuzuar.
3. **134** kërkesa të ndryshme prej të cilave
- 55 kërkesa janë për përkrahje shëndetësore dhe strehim banim, të cilat pas shqyrtimit nga Komisioni për Subvencione dhe Transfere janë përfituese në vlerë prej **20,400 €**,
 - 35 për vërtetime të ndryshme,
 - 31 janë të refuzuara,
 - 3 janë të pezulluara dhe
 - 10 janë në pritje për shqyrtim nga komisioni.

Gjithësejt, subvencione për vitin 2022

55,234

5000 (të bartura nga te hyrat)

60,234

- | | |
|------------------|-----------------|
| a. Të shpenzuara | 59,800 € |
| b. Të mbetura | 434 € |

1. Përpilimi i Aktvendimeve për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në Qendrën Rezidenciale (Shtëpinë e Komunitetit) në bazë të kërkesës së QPS-ve, të komunave të ndryshme në varësi nga cila komunë vijnë banorët;
2. Hartimi i raporteve financiare dhe administrative në funksionimin e organizatës buxhetore.

B. Raport përmbledhës i punës së QKMF , për periudhën 1 Janar deri me 1 Shtator 2022

Kujdesi Primar Shëndetësor publik në Komunën e Shtimes ofrohet përmes rrjetit të institucioneve shëndetësore publike:

QKMF “Dr VEZIR BAJRAMI” Shtime dhe 4 QMF,

- QMF në Pjetërshticë;
- QMF në Muzeqinë,
- QMF në Petrovë (jofunksionale)
- QMF në Godanc, (jofunksionale)

Personeli i QKMF:

QKMF, në kuadër të saj ka të punësuar, 82 punëtorë.

Prej tyre: 18 mjekë, nga ta: 1 specialiste e mjekësisë familjare, 1 internist, 3 stomatologë, dhe 13-të mjekë të mjekësisë së përgjithshme (një në specializim të mjekësisë familjare) dhe nje farmacist të diplomuar. Staf i mesëm profesional : infermier, mami, tek. të stomatologjisë, tek të farmacisë - **50-të**; administratë dhe staf teknik joshëndetësor **13-të**; **19-të** punëtorë tjerë, janë të angazhuar me “Caritas”.

Pas ndërrimit të Qeverisjes komunale në Shtime, kem filluar një riorganizim të ri në QKMF , gjë që ka reflektuar në masë të madhe në rritjen e shërbimeve cilësore dhe përballimin me sukses të Pandemisë me Covid 19.

Është rritur numri i vizitave shëndetësore në QKMF në të gjithë sektorët e saj (Mjekësi Familjare, Urgjencë, Laborator dhe Barnatore) dhe është rritur niveli i angazhimit dhe përgjegjësisë të të gjithë punonjësve shëndetësorë.

Tashmë, kujdesi për nëna dhe fëmijë, si një kategori e posaçme shëndetësore , është në krye të prioriteve tona dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe AQH-së në Kosovë, është duke u realizuar me sukses.

Gjendja shëndetësore e popullatës dhe sëmundjet ngjitëse përcillen dhe raportohen me rregull përmes formave të raportimeve zyrtare në IRSHP në Ferizaj dhe IKSHP Prishtinë.

Megenëse furnizimi me barëra esenciale nga Divizioni Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë në këtë periudhë nuk ka plotësuar nevojat dhe kërkesat, ne kemi siguruar – blerë barëra dhe material

mjekësor nga buxheti ynë i planifikuar për këtë vit, me theks të veçantë për shërbimin emergjent primar, por pa përjashtuar edhe QMF-të dhe shërbimin e Mjekësisë Familjare.

Më 20.12.2022 është nënshkruar edhe një kontratë tjetër për furnizim me barëra në vlerë prej 18.786,59 E, e cila shpresojmë të zbus në masë të madhe mungesën e barërave nga Lista Esenciale.

Gjatë kësaj periudhe , një nga problemet kryesore ka qenë prishja e Rëntgenit, mu pas ndërrimit të pushtetit komunal dhe rregullimi i tij, meqë qeverisja e kaluar, nuk ka paraparë buxhet për mirëmbajtjen e tij. Tashmë rëntgeni në QKMF është funksional dhe shërbimet e kërkuara nga qytetarët janë të qasshme dhe efektive. Tashmë kem regrutuar edhe radiologun gjë që ka bërë të kemi në diaspozicion imazhet e kërkuara, por edhe interpretimin profesional dhe adekuat të tyre, ashtu siç e parashef edhe Ligji për Shëndetësi. I njeiti (radiologu) ka filluar edhe punën me ultrazë, si një mjet diagnostikues dhe të padëmshëm për shëndetin e qytetarit, por gjithashtu edhe një ndihmesë e madhe për mjekët , në diagnostikimin e sëmundjeve tek pacientët që gravitojnë në QKMF.

Dy AMF-të jofunksionale , ajo në Petrovë dhe Godanc, së shpejti do fillojnë të punojnë në formë të klinikave digjitale, pasi përgatitjet e duhura janë bërë dhe tashmë ato janë të finalizuara.

Nga 1 gushti 2022 kem filluar me dhënien e shërbimeve nga gjinekologjia dhe obstetrika, meqë është angazhuar një gjinekolog-obstetër, tre herë në javë në QKMF në Shtime.

Raport per muajin Janar-Nentor- 2022

Gjithsej - Vizita Mjekësore në: QKMF, QMF , URGJENCË		
1	Vizita Mjekësi Familjare	46391
2	Vizita emergjente	43603
3	Vizita gjinekologjike	371
4	Vizita stomatologjike	5245
5	Vizita paliative	1871
6	Vizita radiologjike	567
7	Vizita-Internisti	629
8	Vizita Nëna dhe femiu	699
9	Vizita Sistematike në shkolla dhe kopësht	340
Totali: 99716		

Shërbime shëndetësore

1	Gjithsej injeksione IV, IM, SC, INFUZIONE	45818
---	---	-------

2	Gjithsej lidhje-pasrim plagës, largimi I penjëve, imobilizim	5791
3	Gjithsej Rtg -Echo	2399
4	Gjithsej pacient në laborator	6573
5	Vendosja e kateterit	151
6	Këshillimorja	584
7	Matja e glikemis	770
8	Gjithsej vaksina	7049
9	Shërbime tjera (sh.syrit,veshit)	119
Totali: 69254		
Gjithsej - Vizita Mjekësore& Shërbime shëndetësore		168970

Gjate muajit Tetor Muaji I Ndërgjegjesimit për Kancerin e Gjirit janë kryer gjithsej:

- ✓ 84 ECHO të gjirit
- ✓ 17 Mamografi (janë referuar në QRS-Ferizaj dhe i është caktuar termini).

Sfidat në sektorin e shëndetësisë KPSH:

- Mungesa e specialistëve të mjekësisë familjare;
- Mungesa e profesionistëve të profileve të parapara me legjislacionin shëndetësor në fuqi (Specialist i biokimisë klinike dhe radiolog) për shërbimet që ofrohen;
- Pamundësia e formimit të ekipeve të mjekësisë familjare;
- Listimi dhe krijimi i listave të pacientëve për përzgjedhjen e mjekut familjar dhe Zonimi i Mjekësisë Familjare;
- Ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së, si nevojë për krijimin e hapësirave për ofrimin e shërbimeve sipas konceptit të mjekësisë familjare dhe standardeve të kërkuara;
- Plotësimi i QMF-ve me kuadër dhe paisje mjekësore (QMF Godanc dhe Petrovë);
- SISH-Sistemi informativ shëndetësor, funksional 24 orë dhe rrjetizimi i të gjitha Insitucioneve;
- Furnizim stabil dhe me kohë me barëra nga lista esenciale.

C. Raport përmbledhës për aktivitete e SHKSH-ës, per periudhën Janar-Djetor 2022

Në Shtëpinë e Komunitetit në Shtime, ofrohen shërbime të ndryshme ndaj klientave, me një staf të punëtorëve prej 13-të infermierëve dhe punëtorëve ndihmës (10-të të rregullt dhe 3 punëtorë të kontraktuar me Caritas Kosova), me orar të ndryshme kohor, duke iu përshtatur nevojave shërbyese dhe duke ofruar shërbim klientave 24 orë. Gjatë kësaj periudhe angazhimi i personelit dhe stafit të SHKS, ka qenë i fokusuar rreth kujdesit të klientëve: plotësimi i nevojave ushqimore, higjienike, përcjellja e gjendjes shëndetsore; vizita të përgjithshme mjekësore, specialistike; përcjellja e shenjave vitale, analizat kontrolluese dhe mirëmbajtja e dokumentacionit .Njëkohësisht bëhet përcjellja gjatë shujtave të ushqimit dhe dhënja e terapi së etj.

Numri i klientëve deri me datën 21.07.2022 ka qenë 13, kurse prej datës 22.07.2022 e kënde j është 12 klienta, sepse klienti Misin Bytyqi transferohet në Shtëpinë e Komunitetit në Prizren, përmes Q.P.S . së Suharekës.

VIZITAT FAMILJARE NË SH.K.SH : 77 vizita

VIZITAT E KLIENTEVE NË FAMILJE: 25 vizita

FURNIZIMET: Kemi qenë të furnizuar mirë dhe mjaftueshëm me ushqim, mirëpo ka pasur vonesë te furnizimi me material higjienik, ndonëse kontrata për furnizim është nënshkruar me 17.06.2022, kurse ne s'jemi furnizuar ende, përkundër kërkesës se herëpashershme si te menagjeri kontratës Sylejman Xhelili, njashtu dhe te thirrja ne telefon direkt me kontraktuesin furnizues.

Planifikimet per vitin 2023:

1. Për vitin 2023, kem planifikuar një pushimore me mbulojë dhe ulëse në oborrin e Shtëpisë të Komunitetit, që kohën më të madhe të ditës ta kalojnë në ambientin e hapur, kjo do të ndikonte pozitivisht edhe në shëndetin e tyre.
 2. Një mbulojë e shkallëve konstruksion metali te hyrësja në shtëpi është e domosdoshme, sepse si shiu si bora po paraqesin rrezik për lëvizjet e klientëve gjatë hyrjeve dhe daljeve.
 3. Mbulojë me konstruksion metali për pelet .
 4. Ujerat atmosferike qe po rrjedhin nga Qesta e Reqakut në drejtim te murit rrethues të Shtëpisë të Komunitetit po shkakton problem me rrezikim të shembjes se murit nga betoni.
- Kërkohet të mirret masa ne sajimin e kanaleve të ujerave atmosferike jashtë oborrit të Shtëpisë që po rrezikojnë strukturën e murit rrethues.**

DONACIONET:

1. Kontingjenti turk, në muajin prill dhe qershorë, kanë sjellë pako me duksa për klientët e Shtëpisë të komunitetit.
2. **Afrim Murtezi** nga Mollopolci i Shtimes dhuron: 35 pjata ushqimi për klientë, tavolinë druri me 6 ulëse, shtrat metalik me rrymë për pozicione të ndryshme për nevojat e klientit të sëmurë.
3. **Donator Anonim** – 9 piktura pëlhure me dimensione të ndryshme për Shtëpinë e Komunitetit.
4. **Donator Anonim** – shesblej online- dhurojnë 148 elemente kuzhine (pjata, gota, lugë të ndryshme, e shumë elemente tjera).
5. **Emrah Maliqi** – nga Shtimja, në mënyrë vullnetare rregulloi dyert e oborrit që ishin demoluar nga erërat e forta.
6. **Ventius internacional L.L.C -apo COMODITA HOME-** dhurojnë 15 dyshekë shtrati për 1 person dhe 15 jastëkë për klientët e Shtëpisë të Komunitetit.

TRAJNIMET E STAFIT: Infermierët kanë pasur një trajnim online i organizuar nga OIK.

SYNIMET: Synimet toma janë që në kordinim me DSHMS-ën, klientëve të Shtëpisë të Komunitetit të ju ofrojmë të gjitha shërbimet e nevojshme, me mjetet buxhetore të destinuara nga Komuna e Shtimës, por edhe me thithjen e donacioneve nga shoqata të ndryshme që veprojnë në Kosovë, në mënyrë që t'i realizojmë të gjitha projektet e domosdoshme për një ambientë sa më adekuat, në dobi të klientëve.

D. Raport i punës për periudhën Janar –Dhjetor -2022

Qendra për punë sociale në Shtime

I. DIVIZIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE

1. Shërbimi social në QPS-së në Shtime, ndonëse me mungesa të konsiderueshme të stafit, ka arritur me sukses t'i kryej punët të cilat kanë qenë të parapara me plan, por edhe punë tjera që janë paraqitë dhe kanë qenë me prioritet.

1.Mbrojta e fëmijëve

- **Fëmijë të braktisur -00.** Gjatë këtij 11-të mujori nuk kemi raste të braktisjes së fëmijëve. Në këtë kategori afati është i përhershëm. Realizohet kryesisht nga QPS-ja, por me një bashkëpunim të mire me SHPK-ë Spitalet dhe QPS-së tjera.
- **Fëmijë të mbetur pa kujdes prindëror- 00 .** Gjatë këtij nëntëmujori nuk kemi raste të reja të fëmijëve pa kujdesin prindëror ;
- **Fëmijë të braktisur .** Janë zhvilluar **37** vizita fëmijëve të cilët janë nën kujdestari , afati i përhershëm

2. Besimi i fëmijëve-00 — fëmijë të besuar njërit prind .Nuk ka raste të reja besimit të fëmijëve në këtë periudhë .

3.Kontaktet me-00. Kontakt me fëmijë. Nuk ka raste të reja të kontaktimit me fëmijë ; janë duke u zhvilluar kontaktet e rasteve të më hershme .

4. Të adoptuar–birësuar. Gjatë kësaj periudhe kemi **1** fëmi që kalon në adoptim të plotë. Gjithashtu kemi një familje (që ka një fëmi në fazën provuse). Realizohet sipas afatit ligjor QPS-Shtime.

5. Strehimi familjar- 00 . Gjatë këtij nëntëmujori nuk kemi raste të reja .

6.Mbrojtja e fëmijëve të keqtrajtuar- 01, Gjatë kësaj periudhe kemi një rast të ri të keqtrajtimit të fëmijëve.

7.Mbrojtja e fëmijëve me sjellje delikuate- 24, Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur **24** raste të reja të delikuentëve, janë bërë intervista me të mitur si dhe u janë bërë vizita të rregullta në familje . Afati i përhershëm Realizohet nga QPS-ja dhe me një bashkëpunim të mire të Policisë , Gjykatave,shkollës ,familjes etj.

7-a .Mbrojtja e fëmijëve me sjellje asocial- 00 .Gjatë kësaj periudhe nuk kemi raste të reja të fëmijëve me sjellje asociale,

8. Dhuna në familje – 14 . Kemi **14** (katërmbëdhjetë) raste të reja të dhunës në familje Në bashkëpunim me SHPK-ën dhe QPS-së tjera.

9. Mardhënje të çrregulluara bashkëshortore-03 . Gjatë kësaj periudhe ka dy raste të reja të çrregullimit të mardhënjeve bashkëshortore. Në bashkëpunim me SHPK-ën dhe QPS-së tjera.

10. Këshill martesore –00, Nuk është evidentuar asnjë rast i keshillës martesore.

11. Bashkëpunim me organet tjera . Ka një bashkëpunim të mirë me organet tjera si ato Komunale , SHPK-ë, Gjykatat, Shkollat ,OJQtë- etj.

12. Mbrojtja e personave të moshuar -01 ,Ka **1** rast të ri- kërkesa të reja për vendosje institucionale (Shtëpia për të moshuar pa përkujdesje familjare në Prishtinë). Afati i përhershëm.

13. Mbrojtja e personave me paafësi mentale – 01. Gjatë kësaj periudhe kemi **1** rast të ri, i cili ka nevojë për vendosje institucionale (i mitur). Është refuzuar kërkesa për vendosje institucionale.

14. Shërbime tjera (klient tjerë) -136. Janë shënuar gjithësejt 136 raste të klientëve të tjerë të cilët kanë kërkuar shërbime të ndryshme.

15. Kërkesat për ndihmë të njëhershme- 00 . Gjatë këtij nëntëmujori nuk ka kërkesa për ndihmë të njëhershme, e cila është në procedurë .

16.Fëmijë me aftësi të kufizuar – 07 .Gjatë këtij nëntë mujori kemi **7** raste të reja .

17.Rexhistrim i mëvonshëm-00. Gjatë kësaj periudhe nuk ka raste të reja të rexhistrimit të mëvonshëm .

II. DIVIZIONI I ASISTENCËS SOCIALE

1.Realizimi i SNS. Divizioni i Asistencës sociale i ka vazhduar punët sipas planit dhe orarit të paraparë me Ligjin e SAS-it. Afatet për mbrojtjen e kësaj kategorie janë të parapara në LSAS dhe nëpunësit janë të obliguar t'i përcjellin këto afate. Realizohet nga QPS-ja në terren dhe nga DMS-MPMS

2. Aplikantë të ri .Gjatë kësaj -periudhe kanë aplikuar gjithësejt **18;8** prej tyre janë aprovuar , janë refuzuar 7 raste ,dhe në shqyrtim është 3 raste.

3. Riaplikim- **228** familje kanë riaplikuar. Nga to **222** raste janë aprovuar dhe **6** familje janë refuzuar . Asnjë familje nuk është larguar nga SNS-së për mosriaplikim dhe çështje tjera.

3.Verifikimi . Numri total i familjeve të verifikuara gjatë kësaj periudhe është si në vazhdim: **257** familje janë verifikuar dhe riverifikuar, **214** raste janë aprovuar ,6 janë riaktivizuar, asnjë nuk është në shqyrtim dhe 16, familje janë larguar nga SNS-së për çështje tjera

4.Komision mjekësor Numri i lëndëve të cilat janë dërguar në Komision Mjekësor është si në vazhdim : - **148** raste janë dërgua në komision mjekësor, - **121** raste janë aprovuar, - **38** janë refuzuar;- **00** kompletim të dokumentacionit – **11** në shqyrtim .Numri i ankesave të paraqitura nga ankuesit është si në vazhdim: Janë paraqitur gjithësejt ankesa , -00 ankesa në shkallë të parë , - **00** të aprovuara , - 00 të refuzuara , - **00** në rishqyrtim , - 09 në shkallë të dytë , 01 e pranuar , **07** - e refuzuar, -**01** në shqyrtim. Konteste në Gjykatë . Konteste të pranuar 0 raste , Konteste të refuzuara **0** raste.

Donatorët për vitin 2022, në bashkpunim me QPS-në.

Gjithësejt pako ushqimore dhe hixhenike ne këtë periudhë janë ndarë**1488**.

Sh.P.K.”Eli-ab” Shtime ka përkrahur **150 familje** me gjera ushqimore dhe higjenike - kupona në vlerë prej e 50 E,

Shoqata “Bereqeti” ka përkrahur me pako ushqimore **46** familje në nevojë,dhe 40 familje me dyshekë gjumi,

Chatar Charity ka përkrahur me pako ushqimore **200** familje,

Shoqata “Jetimat e Ballkanit” ka përkrahur 200 familje me pako ushqimore,

Sh.P.K “Matkos” ka përkrahur **100** familje me pako ushqimore,

Kfori turk ka përkrahur **50** familje me pako ushqimore,

Shoqata “Amaneti” donacion pako ushqimore **100** familje,

Qeveria e Kosoves në bashkëpunim me shoqaten “ Jetimat e Ballkanit” kanë ndihmuar **580** familje me pako ushqimore dhe hixhenike.

DSHMS ,12 pako ushqimore dhe hixhenike.

Nr.i perfituesve te skemes :Janar-372; Shkurt-367;Mars-365; Prill-352; Maj-352; Qershor-351 Korrik-352’ Gusht-342.